

MARS 2026

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Mars 2026

© Ministria e Financave, 2026

Drejtoria e Përgjithshme e Programimit Makroekonomik dhe Fiskal
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë

E-mail: Rei.Qerimi@financa.gov.al, Elkejdo.Pacani@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE _____ **2**

ZHVILLIMET EKONOMIKE _____ **3**

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit _____ 3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit _____ 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave _____ 5
4. Bilanci i Pagesave _____ 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar _____ 7
6. Kredia për Ekonominë _____ 8
7. Oferta e Parasë _____ 9
8. Depozitat sipas Burimeve _____ 10

SEKTORI FISKAL _____ **11**

1. Buxheti i Konsoliduar _____ 11
2. Të Ardhurat Sipas Burimeve _____ 12
3. Financimi i Bilancit Fiskal _____ 12

ANEKSI STATISTIKOR _____ **13**

Veçoritë Kryesore

- Indeksi i çmimeve të konsumit, në mars 2026, arriti në 102.63. Norma vjetore e inflacionit për muajin mars 2026 ishte 2.6 përqind;
- Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin mars 2026 ishte 83.06 lekë për dollarë dhe 96.04 lekë për euro;
- Normat mesatare të interesit të depozitave në lekë sipas individëve dhe korporatave jofinanciare gjatë muajit mars 2026 shënuan normën 1.54 dhe 2.47 përqind;
- Normat mesatare të interesit të huave në lekë sipas individëve dhe korporatave jofinanciare gjatë muajit mars 2026 shënuan normën 6.12 dhe 6.30 përqind;
- Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,976,719 milionë lekë në muajin mars 2026, duke shënuar një rritje prej rreth 9.2 përqind krahasuar me një vit më parë;
- Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e katërt 2025 rezultoi afërsisht i balancuar, me një rënie të lehtë të mjeteve të rezervës valutore, duke shënuar vlerën prej rreth -6 milionë euro;
- Situata buxhetore për muajin mars 2026 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej rreth 49.1 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një suficit prej 26 miliardë lekë;
- Të ardhurat gjithsej të realizuara për muajin mars 2026 arritën në rreth 205.7 miliardë lekë, ose afërsisht 13.6 përqind më shumë se muaji mars 2025 dhe 6.1 përqind më shumë krahasuar me planin e periudhës;
- Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë arritën në rreth 156.7 miliardë lekë, ose rreth 6.3 përqind më shumë se muaji mars 2025 dhe 93.3 përqind realizim kundrejt planit të periudhës.

Zhvillimet Ekonomike

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit


Inflacioni vjetor për muajin mars 2026 shënoi normën 2.6%, duke reflektuar rritje në krahasim me një vit më parë kur ky ndryshim ishte 2.1%. Ndryshimi mujor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK) në muajin mars 2026, krahasuar me një muaj më parë, ka shënuar rritje me 0.7%. Inflacioni mesatar për periudhën janar-mars 2026 është 2.5%.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, grupet të cilat patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin:

“Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera” me rritje vjetore të çmimit prej +4.8%, duke kontribuar me +0.95 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.6%.

“Transporti” me rritje vjetore të çmimit prej +7.5%, duke kontribuar me +0.48 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.6%.

“Ushqime dhe pije joalkoolike” me rritje vjetore të çmimit prej +1.3%, duke kontribuar me +0.44 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.6%.



“Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me rritje vjetore +2.6%, duke kontribuar me +0.18 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.6%.

“Restorante dhe shërbime akomodimi” me rritje vjetore të çmimit prej +2.4%, duke kontribuar me +0.13 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.6%.

“Pije alkoolike dhe duhan” me rritje vjetore të çmimit prej +2.0%, duke kontribuar me +0.10 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.6%.

“Kujdes personal dhe mallra e shërbime të ndryshme” me rritje vjetore të çmimit prej +2.0%, duke kontribuar me +0.08 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.6%.

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2025	2.0	1.9	2.1	2.3	2.2	2.4	2.5	2.3	2.4	2.3	2.1	2.3
2026	2.3	2.5	2.6									

Burimi: INSTAT

2. Kursi mesatar i këmbimit


Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin mars 2026 arriti në 96.04 lekë/euro, duke u ulur me 0.41 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit mars, një euro u këmbye me 96.03 lekë. Gjatë muajit mars 2026 kundrejt dhjetor 2025, vihet re një mbiçmim i lehtë i lekut ndaj euros në 0.2 përqind.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin mars 2026 arriti në 83.06 lekë/dollarë, duke shënuar rritje me 1.88 përqind kundrejt një muaji më parë. Në fund të muajit mars, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 83.76 lekë/dollarë. Gjatë muajit mars 2026 kundrejt dhjetor 2025, vihet re një mbiçmim i lehtë i lekut ndaj dollarit në 0.2 përqind.

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan shënoi një nivel mesatar rreth 0.86 dollarë/euro për muajin mars 2026.


Në krahasim me muajin mars të vitit të kaluar, pas një periudhe të konsiderueshme forcimi, rezulton se monedha shqiptare ka pësuar një mbiçmim ndaj monedhës europiane në masën 3.21 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është mbiçmuar në masën 9.62 përqind.

Presionet mbiçmuese mbi kursin e këmbimit vijuan gjatë muajit mars 2026, por ato paraqiten më të moderuara krahasuar me dy vitet e mëparshme. Presionet e brendshme inflacioniste mbeten kontribuesi kryesor në inflacion, si pasojë e zgjerimit të aktivitetit ekonomik, kushteve të shtrënguara në tregun e punës, si dhe rritjes së çmimit të qirave, naftës dhe shërbimeve të transportit. Nga ana tjetër, presionet inflacioniste nga jashtë, ndonëse mbeten ende të dobëta, janë forcuar duke reflektuar rritjen e çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare, si pasojë e zhvillimeve në Lindjen e Mesme. Në përgjithësi, tregu valutor është karakterizuar nga një luhatshmëri e ulët.




3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit mars 2026, normat mesatare të interesit të depozitave me afat në lekë sipas Individëve dhe Korporatave jofinanciare shënuan përkatësisht normat prej 1.54 dhe 2.47 përqind. Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të depozitave sipas Individëve janë ulur me 0.08 pikë përqindje, ndërsa për Korporatat jofinanciare janë rritur me 0.27 pikë përqindje. Ndërsa krahasuar me një vit më parë, normat e interesit të depozitave sipas Individëve kanë shënuar rënie me 0.02 pikë përqindje dhe janë rritur me 0.11 pikë përqindje për Korporatat jofinanciare.



Normat e interesit të bonove të thesarit 12-mujore, për muajin mars 2026, kanë shënuar normën 2.47 përqind, nga 2.72 përqind që shënonte të njëjtën periudhë një vit më parë. Norma e bonos 12-mujore është rritur me 0.04 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë ndërsa krahasuar me një vit më parë, ka shënuar rënie me 0.25 pikë përqindje.

Gjatë muajit mars 2026, normat mesatare të interesit të huave sipas Individëve dhe Korporatave jofinanciare shënuan normën 6.12 dhe 6.30 përqind. Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të huave sipas Individëve u ulën me 0.53 pikë përqindje, ndërsa normat e interesit sipas Korporatave jofinanciare u ulën me 1.12 pikë përqindje. Ndërkohë, krahasuar me një vit më parë, normat e interesit të huave kanë shënuar rritje me 0.12 pikë përqindje për Individët dhe rritje me 0.28 pikë përqindje për Korporatat jofinanciare.





4. Bilanci i Pagesave T4-2025

Në tremujorin e katërt të vitit 2025, Bilanci i përgjithshëm i Pagesave rezultoi afërsisht i balancuar, me një rënie të lehtë të mjeteve të rezervës valutore, duke shënuar vlerën prej rreth -6 milionë euro, nga 293 milionë euro që ishte në tremujorin e katërt 2024.

Llogaria korrente u mbyll me balancë negative prej rreth 254.2 milionë euro, duke u ngushtuar në terma vjetorë me rreth 122 milionë euro. Zgjerimi i suficitit në shërbime dhe balanca pozitive e të ardhurave parësore mbeten faktorët përcaktues të këtij rezultati. Llogaria financiare dhe kapitale rezultoi në fluks neto hyrës prej rreth 170.3 milionë euro, krahasuar me 611.5 milionë euro në tremujorin e katërt 2024.


Investimet e huaja direkte u vlerësuan në 427 milionë euro ose +0.9 përqind më shumë, krahasuar me +423 milionë euro në tremujorin e katërt të vitit 2024. Të ardhurat në formën e prurjeve valutore nga emigrantët shënuan 302 milionë euro, ose +10.8 përqind, krahasuar me +273 milionë euro në tremujorin e katërt 2024.

Gjatë tremujorit të katërt 2025, mjetet e rezervës shënuan një rënie të lehtë prej rreth 6 milionë euro. Stoku i rezervës valutore, në fund të tremujorit të katërt 2025, shënon vlerën prej 7,309 milionë euro, mjaftueshëm për mbulimin e 7.6 muaj importe mesatare vjetore në mallra dhe shërbime.




5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit mars 2026, sistemi bankar ka shënuar vlerën prej rreth 1,129,590 milionë lekë të mjeteve valutore neto (M.V.N), duke u rritur me rreth 56,180 milionë lekë krahasuar me muajin mars 2025. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto në Bankën Qendrore me 36,010 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë, mjetet valutore neto kanë shënuar rënie me 3,193 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rënia mujore prej 5,579 milionë lekë në bankat e tjera depozituese.



Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,976,719 milionë lekë në muajin mars 2026, duke shënuar një rritje prej 165,874 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 9.2 përqind.





Në muajin mars, sistemi bankar rezultoi me rënie mujore prej 7,099 milionë lekë, ose 0.4 përqind më pak krahasuar me muajin shkurt 2026.

6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë në muajin mars 2026 arriti në rreth 958,516 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje në vlerë me 92,085 milionë lekë, ose rritje me rreth 10.6 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (59.3%) dhe monedhave të huaja (40.7%).

Gjatë muajit mars 2026, zëri “Korporata të tjera jofinanciare”, zuri peshën më të lartë të totalit të kredisë, me rreth 54.9 përqind ose 526,275 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për Individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin rreth 41.4 përqind ose rreth 397,194 milionë lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 1.6 dhe 2.1 përqind, ose 14,845 dhe 20,193 milionë lekë.

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin mars 2026, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredisë, me rreth 75.1 përqind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 22.0 përqind. “Korporata të tjera financiare” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me 2.2 dhe 0.7 përqind secili.





7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 482,780 milionë lekë në fund të muajit mars 2026. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në mars 2026 ka shënuar një rritje mujore prej 0.14 pikë përqindje dhe rritje vjetore prej 0.70 pikë përqindje, duke arritur nivelin 24.4 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar rritje mujore prej 0.24 pikë përqindje dhe rritje vjetore prej 1.21 pikë përqindje, duke shënuar nivelin 32.3 përqind.

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin mars 2026, kanë shënuar rritje vjetore prej rreth 31,277 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për Individë, të cilat përbëjnë rreth 74.2 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë, gjatë muajit mars 2026, shënuan rritje vjetore prej 81,426 milionë lekë. Sektori i Individëve në Lekë ka zënë 75.4 përqind të depozitave në lekë.



Në muajin mars 2026, depozitat totale përbëjnë 75.6 përqind të agregatit M3, me një rënie rreth 0.70 pikë përqindje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.



8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit mars 2026, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 75.4 përqind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 16.8 përqind dhe nga “Korporata jofinanciare publike” me 5.5 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 74.2 përqind dhe rreth 22.5 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 74.8 përqind të totalit.

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 1,117,406 milionë lekë të depozitave totale. Ato ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (294,730 milionë lekë), “Korporata jofinanciare publike” (48,847 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (24,979 milionë lekë) dhe “Qeveria lokale” me rreth 7,978 milionë lekë në totalin e depozitave. Gjatë muajit mars 2026, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1,493,939 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë, niveli i depozitave shënoi rënie me rreth 8,078 milionë lekë. Ndërsa krahasuar me një vit më parë, totali i depozitave ka shënuar rritje me 112,703 milionë lekë.




Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për muajin mars 2026 janë mbledhur rreth 205.7 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej rreth 156.7 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 150.8 miliardë lekë shpenzimet korrente, nga të cilat rreth 63.7 miliardë lekë shpenzime për fonde speciale.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (pa përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore) dhe Doganave është rreth 130.6 miliardë lekë (99.7% realizim kundrejt planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor janë rreth 18.0 miliardë lekë (ose 179.6% më shumë se plani i periudhës). Të ardhurat nga fondet speciale janë rreth 48.5 miliardë lekë (ose 1.5% më shumë se plani i periudhës) dhe të ardhurat jotatimore në nivelin 6.5 miliardë lekë (ose 99% realizim kundrejt planit të periudhës).



Nga totali i shpenzimeve korrente prej 150.8 miliardë lekë, 31.9 miliardë lekë (21.2% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 20.1 miliardë lekë (13.4% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime interesi, 11.1 miliardë lekë (7.4% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 0.6 miliardë lekë (0.4% e totalit të shpenzimeve korrente) për subvencione, 63.7 miliardë lekë (42.2%) për shpenzime për fonde speciale, 17.1 miliardë lekë (11.4% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 6.3 miliardë lekë (4.2% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime të tjera.

Shpenzimet kapitale për muajin mars 2026 janë realizuar në masën 5.9 miliardë lekë.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për muajin mars 2026 ishin rreth 205.7 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 197.1 miliardë lekë, të ardhurat jotatimore në rreth 6.5 miliardë lekë.

Tab - 2

Të ardhurat tatimore gjatë muajit Mars 2026 (mln Lekë)

Emërtimi	Mars'26	Mars'25	Mars'26/ Mars'25 Rritja në (%)
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	60,506	56,617	6.9
Tatimi mbi Fitimin	19,605	17,392	12.7
Akcizat	14,945	14,574	2.5
Tatimi mbi të Ardhurat Personale	21,751	20,748	4.8
Taksa Nacionale dhe të tjera	11,553	12,015	-3.8
Taksa Doganore	2,230	2,045	9.0

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Maj 2026

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Balanca buxhetore për muajin mars 2026 shënoi një suficit prej rreth 49.1 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një suficit prej 26 miliardë lekë. Suficiti prej 49.1 miliardë lekë u përdor për financimin e deficitit të brendshëm prej 44.5 miliardë lekë si dhe deficitit të huaj prej 4.6 miliardë lekë.

Për muajin mars 2026, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 205.7 miliardë lekë;

- Realizimi i shpenzimeve në masën 156.7 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin mars 2026, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 197.1 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën më të lartë e zënë shpenzimet korrente me 150.8 miliardë lekë dhe shpenzimet për fonde speciale me rreth 63.7 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly Average)					Vjetor (Annual)					Month
	2022	2023	2024	2025	2026	2022	2023	2024	2025	2026	2022	2023	2024	2025	2026	
Janar	1.3	1.1	0.5	0.4	0.4	1.3	1.1	0.5	0.4	0.4	3.7	7.2	3.4	2.0	2.3	January
Shkurt	1.3	1.1	0.3	0.3	0.5	1.3	1.1	0.4	0.4	0.5	3.9	7.1	2.6	1.9	2.5	February
Mars	2.4	0.7	0.4	0.6	0.7	1.7	1.0	0.4	0.4	0.5	5.7	5.3	2.3	2.1	2.6	March
Prill	0.7	0.0	-0.2	0.1		1.4	0.9	0.3	0.4		6.2	4.6	2.1	2.3		April
Maj	-0.5	-0.3	-0.2	-0.3		1.0	0.7	0.2	0.2		6.7	4.7	2.2	2.2		May
Qershor	-0.1	-0.3	-0.4	-0.2		0.9	0.6	0.1	0.2		7.4	4.5	2.1	2.4		June
Korrik	0.2	-0.1	-0.2	-0.1		0.8	0.5	0.0	0.1		7.5	4.2	2.1	2.5		July
Gusht	0.8	0.6	0.5	0.3		0.8	0.5	0.1	0.1		8.0	4.0	2.0	2.3		August
Shtator	0.6	0.7	0.6	0.7		0.7	0.4	0.1	0.2		8.1	4.1	1.9	2.4		September
Tetor	0.4	0.1	0.1	0.1		0.7	0.4	0.1	0.2		8.3	3.8	1.9	2.3		October
Nëntor	-0.3	-0.2	0.0	-0.2		0.6	0.3	0.1	0.2		7.9	3.9	2.0	2.1		November
Dhjetor	0.4	0.5	0.6	0.7		0.6	0.3	0.2	0.2		7.4	4.0	2.1	2.3		December

Burimi : INSTAT

Source : INSTAT

Tab - 2 Kursi i këmbimit
Exchange rate

Monedha	2022	2023	2024	2025	2026	2026	2026	Currency
					Janar January	Shkurt February	Mars March	
Mesatarja e periudhës								Average of period
USD	113.04	100.65	93.09	86.80	82.27	81.53	83.06	USD
EURO	118.98	108.80	100.71	97.85	96.56	96.44	96.04	EURO
Fundi i periudhës								In the end of period
USD	107.05	93.94	94.26	82.46	81.13	81.64	83.76	USD
EURO	114.23	103.88	98.15	96.77	96.70	96.36	96.03	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3

Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)*Annual Interest Rates (in ALL)*

Në përqindje	2026 Janar January	2026 Shkurt February	2026 Mars March	In percent
<i>Norma e interesit të depozitave për individët</i>				<i>Interest rates on households deposits</i>
Deri në 1 vit	1.29	1.34	1.28	Up to 1 year
Nga 1-2 vite	1.59	1.46	1.37	From 1 to 2 years
Mbi 2 vjet	2.44	2.39	2.30	Over 2 years
<i>Norma e interesit të depozitave për korporatat jofinanciare</i>				<i>Interest rates on nonfinancial corporations deposits</i>
Deri në 1 vit	2.11	2.19	2.44	Up to 1 year
Nga 1-2 vite	2.70	2.37	3.13	From 1 to 2 years
Mbi 2 vjet	2.75	3.10	2.95	Over 2 years
<i>Normat e interesit të kredive për individët</i>				<i>Interest rates on household loans</i>
Kredi për banesa	3.91	4.07	3.86	Lending for house purchase
Kredi konsumatore	8.63	8.32	8.24	Consumer credit
Kredi për qëllime të tjera	13.10	12.63	9.12	Credit for other purposes
<i>Normat e interesit të kredive për korporatat jofinanciare</i>				<i>Interest rates on nonfinancial corporations loans</i>
Kredi deri në 140 milionë lekë	6.79	7.27	6.65	Loans up to to an amount of 140 millions of lek
Kredi mbi 140 milionë lekë	5.10	7.84	5.93	Loans over an amount of 140 millions of lek
<i>Norma e letrave me vlerë</i>				<i>Securities rates</i>
Bono thesari 1/				Treasury bills 1/
3-M	2.46	-	-	3-M
6-M	-	-	2.39	6-M
12-M	2.44	2.43	2.47	12-M

Burimi: Banka e Shqipërisë**Source:** Bank of Albania

TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2026

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2026

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lek (in million ALL)

Nr.	E M È R T I M I	January Janar	February Shkurt	March Mars	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	69,989	130,390	205,735	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	158	332	2,086	Grants
II.	Të ardhura tatimore	67,671	125,403	197,123	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	43,760	80,803	130,590	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	22,475	39,987	60,506	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	3,442	7,399	19,605	Profit Tax
3	Akcizat	5,208	10,027	14,945	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	7,606	14,070	21,751	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	4,414	7,971	11,553	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	614	1,348	2,230	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	6,875	12,224	18,046	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	539	955	1,812	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	15	61	856	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	6,321	11,207	15,378	Local Taxes
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	17,035	32,376	48,487	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	14,653	27,992	41,992	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetësor	2,316	4,254	6,277	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	66	131	218	Compensation income in the value of owners
III.	Të ardhura Jotatimore	2,160	4,655	6,527	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	0	0	0	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	1,082	2,690	3,631	Income of budgetary institutions
3	Tarifat shërbimeve	354	619	857	Utility fees
4	Të tjera	724	1,346	2,040	Others
	TOTALI I SHPENZIMEVE	48,282	100,683	156,683	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	47,555	98,929	150,809	Current Expenditures
I.1	Personeli	10,287	20,705	31,914	Personnel expenditures
1	Paga	8,825	17,771	27,407	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	1,451	2,909	4,455	Social insurance contributions
3	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta	12	25	52	Higher education from its own income
I.2	Interesat	9,274	16,430	20,130	Interest
1	Të Brendshme	8,365	12,291	14,924	Domestic
2	Të Huaja	909	4,139	5,207	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	2,304	6,741	11,082	Operational & Maintenance
I.4	Subveconet	109	324	565	Subsidies
I.5	Shpenzime për fonde speciale	20,093	41,241	63,704	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	16,066	32,186	49,472	Social insurance
2	Sigurime Shëndetësore	4,043	8,857	13,833	Health insurance
3	Fondi i kompensimit të pronarëve	-17	199	399	Owners' Compensation Fund
I.6	Shpenzime për Buxhetin Vendor	3,996	9,596	17,121	Local budget expenditure
I.7	Shpenzime të tjera	1,492	3,892	6,293	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	59	126	204	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	1,433	3,365	5,384	Economic Aid
3	Kompensim për ish të përndjekurit politike	0	200	405	Compensation for the political persecuted
II	Fondi Rezerve, Kontigjenca	0	0	0	Reserve fund/contingency
III	Shpenzime Kapitale	728	1,754	5,874	Capital expenditures
1	Financimi i Brendshëm	0	6	2852	Domestically financing
2	Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë	0	2	129	From higher education system's own revenues
3	Financimi i Huaj	728	1,695	2,766	Foreign financed
IV	Fondi i rindërtimit	0	52	126	Reconstruction fund
V.	DEFICITI	21,707	29,707	49,053	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-21,707	-29,707	-49,053	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-20,517	-27,570	-44,460	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	3	7	13	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	-13,428	-20,900	-35,760	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-7,092	-6,677	-8,712	Others
V.3	I huaj	-1,190	-2,138	-4,593	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	517	1,406	2,026	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	106	72	16	Chang. of stat. Account
3	Ripagesat	-1,813	-3,964	-6,983	Repayments
4	Mbështetje Buxhetore	0	349	349	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

* "Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja.

Tab - 5

Tabela e investimeve 2026

Table of investments 2026

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lek (in million ALL)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	
Financim i brendshëm	-20,517	-27,570	-44,460	Domestic financing
<i>Në %</i>	94.5	92.8	90.6	<i>In %</i>
Financim i huaj	-1,190	-2,138	-4,593	Foreign financing
<i>Në %</i>	5.5	7.2	9.4	<i>In %</i>
Totali	-21,707	-29,707	-49,053	Total
<i>Në %</i>	100	100	100	<i>In %</i>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

**Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE DHE TATIMORE 2026
CUSTOMS AND TAX REVENUES 2026**

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lek (in million ALL)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	
TË ARDHURAT DOGANORE 2026 (CUSTOMS REVENUE)				
Taksë doganore	614	1,348	2,230	Customs Duties
TVSH	10,123	21,493	35,349	V.A.T
Akcizë	5,208	10,027	14,945	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	63	234	357	Others (Mineral Rent)
TOTALI	16,008	33,102	52,880	Total
TË ARDHURAT TATIMORE 2026 (TAX REVENUE)				
TVSH	12,352	18,494	25,157	V.A.T
Tatim mbi fitimin	3,442	7,399	19,605	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	7,606	14,070	21,751	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	4,351	7,737	11,196	National taxes
TOTALI	27,752	47,701	77,710	Total
TOTALI I PËRGJITHSHËM	43,760	80,803	130,590	OVERALL TOTAL

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 7

DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2026*The Deficit and Its Financing for 2026**Të dhëna progresive (Progressive Data)**në milionë Lek (in million ALL)*

	Janar January	Shkurt February	Mars March	
TË ARDHURAT	69,989	130,390	205,735	REVENUE
SHPENZIMET	48,282	100,683	156,683	EXPENDITURES
BILANCI FISKAL	21,707	29,707	49,053	FISCAL BALANCE
FINANCIMI I BILANCIT FISKAL	-21,707	-29,707	-49,053	FINANCING
Financimi i brendshëm	-20,517	-27,570	-44,460	Domestic
Të ardhura nga privatizimi	3	7	13	Privatization receipts
Hua-marrje e brendshme	-13,428	-20,900	-35,760	Domestic borrowing
Të tjera	-7,092	-6,677	-8,712	Others
Financimi i jashtëm	-1,190	-2,138	-4,593	Foreign
a. Hua afatgjatë (e marrë)	517	1,406	2,026	Long-term foreign borrowing (gross)
b. Ndryshimi i gjendjes së arkës*	106	72	16	Chang. of stat. Account
c. Ripagesat	-1,813	-3,964	-6,983	Repayments
d. Mbështetje Buxhetore	0	349	349	Budgetary Support

Burimi: Ministria e Financave**Source:** Ministry of Finance

BILANCI I PAGESAVE

Balance of payments

Në milionë Euro

In millions Euro

	2022	2023	2024	2025	T1-2025	T2-2025	T3-2025	T4-2025	
Llogaria korrente	-1,118.48	-364.08	-608.68	-178.62	-316.27	-289.92	681.81	-254.20	Current Account.
Bilanci tregtar	-4,320.97	-4,633.52	-5,592.91	-5,956.66	-1,271.75	-1,482.48	-1,610.18	-1,592.25	Trade Balance.
Eksporti I mallrave fob	1,880.46	1,742.43	1,678.80	1,563.90	399.61	425.73	333.51	405.00	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	6,201.43	6,375.96	7,271.71	7,520.56	1,671.36	1,908.21	1,943.70	1,997.30	Merchandise Imports. Fob
Bilanci i shërbimeve	2,398.20	3,351.11	3,875.55	4,470.11	693.94	892.18	1,917.35	966.60	Services Balance.
Shërbimet Kredi	4,798.25	6,564.98	7,409.82	8,476.44	1,492.33	1,859.62	3,163.94	1,960.60	Services Credit
Shërbimet Debi	2400.05	3,213.87	3534.27	4006.33	798.38	967.44	1,246.59	993.90	Services Debt
Bilanci i të ardhurave	-314.76	-278.45	-192.76	-50.68	-40.57	-41.89	21.26	10.50	Balance of Incomes
Të ardhurat Kredi	596.79	771.30	958.77	1,058.79	228.88	259.13	285.18	285.60	Income Credit
Të ardhurat Debi	911.55	1,049.75	1,151.54	1,109.47	269.45	301.03	263.92	275.10	Income Debt
Bilanci i transfertave	1,119.06	1,196.78	1,301.44	1,358.61	302.10	342.28	353.39	360.80	Balance of Transfers
Transferta private	1,280.21	1,367.95	1,507.51	1,589.09	357.46	399.06	411.88	420.70	Private Unrequired Transfers
Transferrat shtetërore	161.16	171.18	206.07	230.48	55.36	56.78	58.49	59.80	Official Unrequired Transfers
Llogaria kapitale	20.14	45.81	-156.44	-99.39	-35.04	-8.10	-17.78	-38.50	Capital Account
Llogaria financiare	-820.99	-1,002.05	-892.46	-1,198.87	-928.13	-268.47	206.51	-208.78	Financial Account
Investime direkte	-1,189.95	-1,255.64	-1,340.04	-1,332.20	-293.19	-305.60	-377.14	-356.27	Direct Investment
Investime portofoli	573.11	326.51	404.94	246.17	-560.99	-95.95	234.65	668.46	Portfolio Investment
Investime të tjera	-266.63	-176.45	-98.97	-198.19	-115.78	106.43	334.94	-523.78	Other Capital
Gabime dhe harresa neto	207.55	253.03	136.37	209.40	-0.44	82.43	49.52	77.89	Net errors and omissions
Bilanci i përgjithshëm	-69.80	936.81	263.71	1,130.26	576.38	52.88	507.04	-6.03	Overall Balance
Rezervat	-69.80	936.81	263.71	1,130.26	576.39	52.89	507.05	-6.06	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	-62.48	-103.53	-141.59	-85.35	-41.84	-26.65	-14.06	-2.80	Use of Fund Credit and Loans

Burimi: Banka e Shqipërisë

Source: Bank of Albania

MJETET VALUTORE NETO

Net Foreign Assets

Në milionë Lekë	2022	2023	2024	2025	2026 Janar	2026 Shkurt	2026 Mars	Millions of Lek End of Period
Fundi i periudhës					January	February	March	
Mjete valutore neto	892,687	975,231	1,016,861	1,125,009	1,128,698	1,132,783	1,129,590	Net foreign assets
Pretendime ndaj jorezidentëve	981,133	1,054,939	1,101,478	1,265,903	1,244,463	1,255,254	1,240,847	Claims on nonresidents
Minus Detyrime të jorezidentëve	88,446	79,707	84,617	140,894	115,765	122,471	111,257	Minus: Liabilities to nonresidents
Mjetet e brendshme	1,211,348	1,218,505	1,326,853	1,455,716	1,485,238	1,486,035	1,481,606	Domestic assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	491,750	467,993	483,962	504,915	538,739	531,811	515,730	Net claims on central government
Pretendime ndaj sektorëve të tjerë	719,598	750,511	842,892	950,801	946,499	954,224	965,876	Claims on other sectors
Detyrimet e parasë së gjerë	1,659,293	1,701,598	1,785,246	1,967,794	1,988,338	1,983,818	1,976,719	Broad Money liabilities
Paraja jashtë Korporatave Depozituese	387,652	393,796	423,539	483,446	481,172	481,801	482,780	Money outside depository corporations
Depozita të transferueshme	645,637	689,106	727,641	806,699	826,185	819,699	810,114	Transferable deposits
Depozita të tjera	626,005	618,696	634,066	677,649	680,981	682,319	683,825	Other deposits
Depozita të papërfshira në parane e gjerë	248,219	294,121	330,099	355,060	355,835	356,993	361,600	Deposits excluded from Broad Money
Qeveria lokale dhe administrata publike								Local government and public administration
Korporata të tjera financiare	7,250	8,065	11,289	9,442	9,585	9,477	9,699	Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike	382	338	464	687	687	689	725	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	10,186	14,936	19,479	22,495	22,634	22,669	22,693	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	230,401	270,783	298,866	322,435	322,928	324,157	328,483	Other resident sectors
Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet	7,925	13,331	20,320	28,668	28,616	28,632	28,608	Securities other than shares
Korporata të tjera jofinanciare	291	614	1,167	1,415	1,405	1,403	1,395	Korporata të tjera jofinanciare
Sektorë të tjerë rezidentë	7,634	12,717	19,153	27,253	27,211	27,229	27,213	Other resident sectors
Huatë	4,636	5,880	4,609	8,671	14,889	10,950	12,346	Loans
Qeveria lokale dhe administrata publike								Local government and public administration
Korporata të tjera financiare	4,636	5,880	4,609	8,671	14,889	10,950	12,346	Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike								Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare								Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë								other resident sectors
Llogari të pagueshme	86	110	42	58	116	198	14	Accounts payable
Korporata të tjera financiare								Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike								Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	69	0		1	1		1	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	17	110	42	57	115	198	13	other resident sectors
Aksione dhe instrumenta të tjerë të kapitalit	191,658	191,644	215,912	244,550	247,018	252,662	246,334	Shares and other equity
Nga të cilat rezerva rivlerësimi	-46,106	-73,037	-76,032	-75,466	-71,105	-66,176	-62,604	Of which: Valuation adjustment
Të tjera neto	-12,607	-14,425	-16,043	-25,637	-22,683	-16,769	-19,097	Other items net
Detyrime të tjera	63,859	63,808	67,937	69,158	71,761	76,717	74,695	Other liabilities
Minus: Mjete të tjera	76,467	78,234	83,980	94,795	94,444	93,485	93,793	Minus: Other assets
Axhustimi i konsolidimit	4,826	1,478	3,529	1,560	1,806	2,333	4,672	Consolidation adjustment

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - KREDIA PËR EKONOMINË
10 Credit to Economy

Në milionë Lekë	2022	2023	2024	2025	2026 Janar	2026 Shkurt	2026 Mars	Millions of Lek End of Period
Fundi i periudhës					January	February	March	
Totali i kredisë	713,552.1	744,162.6	835,816.7	943,744.9	939,337.7	946,861.6	958,516.3	Total Credit
Kredia për qeverinë lokale dhe administratën publike	204.8	103.0	23.9	11.4	10.8	10.3	9.8	Credits to local Government
Në lekë	204.8	103.0	23.9	11.4	10.8	10.3	9.8	in Lek
Në valutë	0	0	0	0	0	0	0	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare publike	23,714.0	16,754.0	18,958.8	18,999.2	18,416.2	16,955.1	14,845.0	Credits to Public Non-financial Corporations
Në lekë	10,508.7	9,247.1	7,354.1	12,345.3	12,164.4	12,072.1	12,029.6	in Lek
Në valutë	13,205.4	7,507.0	11,604.7	6,654.0	6,251.7	4,883.0	2,815.4	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera jofinanciare	411,853.0	421,985.1	469,926.0	516,591.2	511,578.6	518,177.3	526,274.9	Credits to other Non-financial Corporations
Në lekë	173,607.4	196,936.3	216,945.6	230,171.7	227,553.5	227,712.7	233,126.6	in Lek
Në valutë	238,245.6	225,048.8	252,980.4	286,419.5	284,025.1	290,464.6	293,148.4	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera financiare	15,557.4	19,468.4	22,212.3	20,820.0	20,673.2	20,288.9	20,192.7	Credits to Other Financial Corporations
Në lekë	8,668.9	12,411.3	14,719.3	12,293.1	12,098.7	11,975.2	11,673.5	in Lek
Në valutë	6,888.4	7,057.0	7,493.0	8,526.8	8,574.5	8,313.7	8,519.2	in Foreign Currency
Kredia për sektorë të tjerë rezidentë	262,222.9	285,852.1	324,695.7	387,323.2	388,659.0	391,430.0	397,193.9	Credits to other resident sectors
Në lekë	175,900.8	204,247.3	245,076.4	300,731.8	303,253.1	306,239.7	311,465.6	in Lek
Në valutë	86,322.1	81,604.8	79,619.3	86,591.4	85,405.9	85,190.3	85,728.3	in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 11

OFERTA E PARASË

Money Supply

Mujor-Monthly

	2022	2023	2024	2025	2026 Janar January	2026 Shkurt February	2026 Mars March	
Në milionë Lekë								Millions of Lek
Fundi i periudhës								End of Period
Baza monetare	619,187	632,446	613,646	676,586	682,616	676,185	683,092	Monetary base
Paraja jashtë korporatave depozituese	387,652	393,796	423,539	483,446	481,172	481,801	482,780	Currency outside depository corporations
Agregati M1	735,839	772,430	845,659	967,787	988,414	982,561	976,375	M1 Aggregate
Agregati M2	939,309	976,037	1,052,791	1,194,179	1,218,503	1,214,801	1,209,770	M2 Aggregate

Burimi : Banka e Shqipërisë*Source* : Bank of Albania

DEPOZITAT

Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2022	2023	2024	2025	2026 Janar January	2026 Shkurt February	2026 Mars March	Millions of Lek End of Period
	Totali i depozitave	1,271,642	1,307,802	1,361,707	1,484,349	1,507,167	1,502,018	
Në lekë	551,657	582,241	629,252	710,733	737,331	733,000	726,990	In local currency
Depozitat e transferueshme	291,263	323,523	362,855	417,954	440,256	433,422	424,871	Transferable deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	1,694	2,000	3,536	2,702	3,118	2,903	2,998	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	16,031	21,228	22,175	24,937	33,902	33,150	32,188	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	7,045	4,993	5,818	5,974	5,996	6,436	5,520	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	77,667	91,605	96,156	108,851	119,711	110,969	104,146	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	188,826	203,698	235,169	275,490	277,528	279,963	280,019	Other resident sectors
Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)	56,924	55,111	59,266	66,387	66,987	67,338	68,724	Liquid deposits (Sight deposits)
Qeveria lokale dhe administrata publike								Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	2,636	1,669	3,535	1,050	1,036	1,045	1,000	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	37	46	1	25	0	0	0	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	2,493	3,745	3,821	6,640	6,418	6,162	6,450	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	51,758	49,651	51,909	58,672	59,533	60,131	61,274	Other resident sectors
Depozita të tjera	203,470	203,607	207,131	226,391	230,089	232,240	233,395	Other deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike			1,003	1,007	1,010	1,013	2,008	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	598	2,656	3,901	5,235	5,575	5,908	6,827	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	5,114	5,392	5,659	6,837	6,924	7,265	6,318	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	6,379	9,553	9,789	10,298	11,452	11,638	11,209	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	191,379	186,006	186,778	203,013	205,128	206,417	207,032	Other resident sectors
Në valutë	719,985	725,561	732,456	773,616	769,836	769,018	766,949	In foreign currency
Depozitat e transferueshme	354,374	365,583	364,787	388,745	385,930	386,277	385,244	Transferable deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	76	154	106	121	136	143	162	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	3,901	4,128	3,967	6,076	6,604	6,928	6,369	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	6,598	5,359	5,416	5,049	4,864	4,385	5,466	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	136,911	148,159	144,201	153,523	149,853	148,495	149,608	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	206,889	207,783	211,098	223,975	224,473	226,325	223,638	Other resident sectors
Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)	139,409	129,272	126,200	129,044	128,999	128,330	126,460	Liquid deposits (Sight deposits)
Qeveria lokale dhe administrata publike		2	1	1	1	1	1	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	101	6	6	6	6	6	6	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	1	0	0	5	5	13	12	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	4,702	6,408	5,970	6,840	6,448	6,796	6,421	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	134,605	122,856	120,222	122,192	122,540	121,514	120,020	Other resident sectors
Depozita të tjera	226,202	230,706	241,469	255,827	254,907	254,411	255,246	Other deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	984	219	2,572	2,635	2,637	2,872	2,808	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	2,607	2,923	2,374	2,045	2,052	2,072	2,458	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	7,561	8,183	10,107	8,113	7,588	7,457	7,663	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	23,903	22,444	19,474	18,062	17,507	17,127	16,896	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	191,147	196,937	206,942	224,972	225,122	224,883	225,422	Other resident sectors

Burlimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tregues të shëndetit financiar (FSI)

(në përqindje)

Financial Soundness Indicators (FSI)

(in percentage)

Përshkrimi i treguesit	Janar'26	Shkurt'26	Mars'26	Indicator's description
Tregues me bazë kapitalin				Capital-based
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik (në %)	-	-	20.44	Regulatory capital as a percent of risk-weighted assets (in %)
Kapitali rregullator (mln lekë)	-	-	237,123.91	Regulatory capital (million lek)
Aktive të ponderuara me rrezik (mln lekë)	-	-	1,160,166.90	Risk-weighted assets
Kapitali rregullator i nivelit I ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik (në %)	-	-	18.58	Regulatory Tier 1 capital as a percent of risk-weighted assets (in %)
Kapitali ndaj totalit të aktiveve				Capital as a percent of total assets
Kapitali rregullator i nivelit I ndaj totalit të aktiveve	8.91	8.81	9.42	Regulatory Tier 1 capital as a percent of total assets
Kapitali rregullator ndaj totalit të aktiveve (në %)	9.85	9.76	10.36	Regulatory capital as a percent of total assets (in %)
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve (në %)	10.13	10.12	10.29	Shareholders' equity as a percent of total assets (in %)
Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit (në %)				Nonperforming loans net of provisions as a percent of capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit rregullator të nivelit I (në %)	6.25	6.09	6.56	Nonperforming loans net of provisions as a percent of regulatory Tier1 capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit rregullator (në %)	5.65	5.49	5.96	Nonperforming loans net of provisions as a percent of regulatory capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit aksioner (në %)	5.50	5.30	6.00	Nonperforming loans net of provisions as a percent of shareholders' equity (in %)
Kthimi nga kapitali (ROE) (bazë vjetore) (në %)	13.90	13.23	11.83	Return on equity (ROE) (annual basis) (in%)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit (në %)				Net open position in foreign exchange as a percent of capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregullator të nivelit I (në %)	5.74	6.85	7.31	Net open position in foreign exchange as a percent of regulatory Tier 1 capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregullator (në %)	5.19	6.18	6.64	Net open position in foreign exchange as a percent of regulatory capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit aksioner (në %)	5.05	5.96	6.68	Net open position in foreign exchange as a percent of shareholders' capital (in %)
Tregues me bazë aktivet				Asset-based indicators
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda e gjerë)	31.27	31.10	30.65	Liquid assets as a percent of total assets (broad measure)
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda bazë)	30.72	30.69	30.41	Liquid assets as a percent of total assets (core measure)
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda e gjerë)	44.80	44.57	44.06	Liquid assets as a percent of short-term liabilities (broad measure)
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda bazë)	44.02	43.99	43.72	Liquid assets as a percent of short-term liabilities (core measure)
Kthimi nga aktivet (ROA) (bazë vjetore) (fitimi neto para taksave)	1.67	1.57	1.43	Return on assets (ROA) (annual basis) (net profit before taxes)
Huatë me probleme (bruto) ndaj totalit të huave (në %)	3.85	3.80	3.85	Nonperforming loans (gross) as a percent of total loans (in %)
Tregues të të ardhurave dhe shpenzimeve				Income and expense-based
Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto	76.51	75.88	77.33	Interest margin to gross income
Shpenzime jointeresi ndaj të ardhurave bruto	55.66	57.52	59.13	Noninterest expenses to gross income
Të tjera				Other
Numri i bankave	11.00	11.00	11.00	Number of banks

Burimi: Banka e Shqipërisë

Source: Bank of Albania